

TOMOR ALIZOTI

Datëlindja: 06.12.1976

Vendlindja: Lushnje

Email: Tomor.Alizoti@parlament.al

Telefon:

Jetëshkrimi:

Z. Tomor Alizoti ka mbaruar studimet e larta për gjermanisht në vitin 2000, në vitin 2002-2003 diplomuar për pedagogji në gjuhën gjermane dhe më tej për sociologji në vitin 2006 në Mannheim në Gjermani. Në vitin 2007 ka kryer kolegjin diplomatik të Berlinit, si edhe ka kryer specializim në fushën e diplomacisë.

Ai ka shërbyer më parë si diplomat, ku ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Parë për 4 vite (2006-2010) në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Berlin.

Ai ka punuar si pedagog në disa universitet private në vend si Univeristeti Illyra (2011-2012) dhe në Universitetin Justiniani. Gjatë periudhës 2014-2015 ka qenë këshilltar në Bashkinë e Tiranës.

Gjithashtu, Z.Alizoti ka drejtuar Departamentin e të Përndjekurve Politikë pranë Partisë Demokratike Shqiptare dhe është anëtar i Kryesisë së PDSH.

Z. Tomor Alizoti është mandatuar për herë të parë si deputet i Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 2021, në siglën e Aleancës për Ndryshim.